



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



| | | | |
|---|-------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Primitja / Dorezimi Prilijeno/Prodato Received/Delivery | 29.12.2021 | 1 | viti god year |
| Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit | Nr Prot Br Prot Prot No | Shtojca Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity |
| SKRIPSHIK | 6395/2021 | | 1/3 |

Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A. Nr.939/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave nga: anëtarë, nga Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Rushit Kajtazi- Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A. Nr. 939/2021, të datës 17.11.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi Rruga " Ndue Perllushi ", A. 7 OB-B, kati VI, nr. 26 nga Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Agjencia Kosovare e Privatizimi, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nen paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim me datë 28.12..2021, mori këtë;

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A. Nr. 939/2021 e datës 17.11.2021, e parashtruar nga ankuesi

II. MBETET NË FUQI Vendimi i datës 11.11.2021, me numër protokollit 4451, i Komisionit Disiplinor i Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, në pozitën Zyrtar Kadastral në Zyrën Rajonale në AKP-Prishtinë me datë 17.11.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, kundër Vendimit me numër protokollit 4451/2021 të datës 11.11.2021 të Komisionit Disiplinor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, me të cilin vendim i është shqiptuar masa disiplinore "Ndalim i ngritjes në detyrë, duke përfshirë rritjen e shkallës së pagës për periudhën dy (2) vjeçare".



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, më datë 19.11.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Agjencia Kosovare e Privatizimit. Ndërsa, Këshilli më datë 17.11.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas konstatimit së ankesa është e pranueshme sipas nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, për vendosje meritore, ka administruar këto prova: Ankesën A. nr. 939/2021, e datës 17.11.2021, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e datës 11.11.2021, me numër protokoll 4451/2021, i Komisionit Disiplinor; Inicimi i procedurës disiplinore i datës 15.10.2021; Propozimi i datës 10.12.2020, i Ndërmarrjes Publike Banesore; Ekspertizë e datës 08.12.2020; kërkesë për shërbime kadastrale e datës 04.11.2020; procesverbali i datës 10.11.2020, Procesverbali nga tereni; procesverbali nga tereni; Ankesë e datës 16.12.2020, drejtuar Komunes së Prishtinës; e- maili i datës 16.12.2020, i ankuesit e- maili i datës 13.11.2021, i ankuesit procesverbali i datës 06.11.2020; raporti i datës 12.10.2020; Procesverbali i datës 10.11.2021, i Komisionit disiplinor; Përgjigja në ankesës e datës 01.12.2021, me numër protokoll 5712/2021.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkëngjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pa bazuar sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon së Komisionit Disiplinor i Agjencisë Kosovare të Privatizimit, i ka shqipëruar masën disiplinore „ ndalim i ngritjes në detyrë duke përfshirë këtu rritjen në shkallen e pagës për periudhën dy (2) vjeçare” në kundërshtim me ligjin e procedurës së përgjithshëm administrative nenin 47 dhe 48 të Ligjit nr.05/L-031. Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar së pretendimet ankimore të ankuesit nuk janë në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi së ne rastin konkret komisioni disiplinor, ankuesi i ka shqiptuar masën disiplinore në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi duke arsyetuar konform ligjit vendimin me të cilit ankuesit i është shqiptuar masa disiplinore dhe duke sqaruar mirë se ankuesi ka bërë tejkalim të autorizimeve.

Kolegji bazuar në shkresat e lëndës ka konstatuar se ankuesi me datë 06.11.2020 ka dalë në teren dhe ka nënshkruar procesverbalin në të cilin procesverbal është shkruar qartë se procesverbali ka të bëjë me përcaktimin e vijave kufitare në mesë parcelave të P-7495-2 dhe P-7495-3, duke bërë tejkalimin e kompetencave të tijë, Kolegji konstaton se nuk qëndron pretendimi se ankuesi ka nënshkruar procesverbal për daljen ne vendin e ngjarjes, por ankuesi ka nënshkruar procesverbal për ndarjen dhe caktimin e vijave kufitare në mesë të parcelave të lartshënuar dhe siç shihet nga shkresat e lëndës lidhur me caktimin e kufirit në mesë të këtyre parcelave ka pasur të hapura çështje ligjore. Prandaj edhe pse ka pasur të hapura çështje ligjore për përcaktimin e vijave kufitare në mesë të parcelave të lartshënuara me nënshkrimin e procesverbalit nga ana e ankuesit

është bërë e mundur përcaktimi i vijave kufitare pa u sqaruar temat ligjore që kanë qenë të ngritura në mesë të parcelave të lartshënuara.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar së Komisioni Disiplinor i Agjencisë Kosovare të Privatizimit, ne rastin e shqiptimit të masës disiplinore për ankuesin

ka vepruar në pajtim, me nenin 47, , paragrafi 1, nen paragrafi,1.3 të Ligjit NR. 06/L - 114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se; **1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet, si dhe në pajtim me nenin 11, paragrafi 1, nen paragrafi 1.1,1.2, të Rregullores (QRK) nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, ku përcaktohet se; 1. Komisioni disiplinor ka këto kompetenca: 1.1. Bënë shqyrtimin e fakteve dhe provave të paraqitura;1.2. Përcakton dhe shqipton masë disiplinore.**

Prandaj, Kolegji duke u mbështetur në shkresat e lëndës ka marrë si rrethanë faktike tejkalimin e autorizimeve nga ana e ankuesit kur ka vendosur që të refuzoj ankesën.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit si dhe në pajtim me nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Lënda Nr. A. Nr. 939/2021

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Eshref SHABANI

Kryetarë e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit;
- Drejtorit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit;
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit;
- Arkivit të KPMSHCK-së